

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)68 20 67 630
E-mail: info@qkzh.org

www.qkzh.org

Rezultatet e vrojtimt të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 21, shtator 2006



*Business and Consumer
Survey Results
No 21, september 2006*

INDUSTRIA PËRPUNUESE


MANUFACTURING SECTOR

Treguesi i besueshmërisë së biznesit në sektorin e industrisë përpunuese në muajin korrik 2006 shënon një rritje prej 4 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, duke arritur nivelin e para një viti. Në këtë rezultat ka ndikuar përmirësimi i ndjeshëm i nivelit të kontraktimeve në përgjithësi, dhe në veçanti ato për eksport, si dhe ulja e stokut të produkteve të gatshme.

Një ndikim pozitiv në përmirësimin e klimës së biznesit ka dhënë gjithashtu, përmirësimi i furnizimit me energji elektrike i këtij sektori, stabiliteti makroekonomik, si dhe përmirësimi i ndjeshëm i kredihënies. Një ndikim negativ në këtë sektor vazhdon të kenë faktorë të tillë si konkurenca e pandershme nga tregu i zi, si dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar.

Në muajin korrik 2006, *treguesi i besueshmërisë* në sektorin e industrisë përpunuese është në nivelin pozitiv prej 8 pikësh duke treguar për një rritje të optimizmit të drejtuesve të firmave prodhuese në këtë sektor. Ky nivel i krahasuar me një vit më parë është i pandryshuar (shiko figurën 1). Rritja e treguesit të besueshmërisë me 4 pikë në krahasim me balancën në përqindje për të njëjtin tregues në muajin prill ka ardhur si rezultat i përmirësimit të nivelit

FIGURA 1: Treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

të kontraktimeve në këtë sektor, si dhe uljes së nivelit të stokut të produkteve të gatshme për këtë sektor, ndërsa parashikimi i aktivitetit të biznesit në 3 muajt e ardhshëm ka dhënë një ndikim negativ në nivelin e treguesit të besueshmërisë. Rritja e treguesit të besueshmërisë në muajin korrik 2006 krijon premisat e duhuara për një konsolidim të situatës aktuale të biznesit, si dhe një mundësi rritjeje në 3-mujorin e tretë të këtij viti.

Klima e biznesit sipas sektorëve në industrinë përpunuese

Nga analiza e treguesit të QKZH për besueshmërinë në nëndegët e industrisë përpunuese, (shiko figurën 2) vëme re se industria ushqimore, pijeve dhe duhanit ka një tendencë në rritje nga niveli negativ i 5 pikëve në prill 2006 në nivelin e 13 pikëve në anketimin e fundit të korrik 2006 ndërsa industria e fabrikimit të artikujve prej druri, mobiljeve ka shënuar një përmirësim të dukshëm prej 12 pikësh në përqindje në krahasim me tre muaj më parë. Industria e tekstileve, veshjes dhe lekurë këpucëve ka një rënie të treguesit të besueshmërisë me 8 pikë në përqindje nga tre mujori i kaluar.

Industria e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike ka një tendencë rënieje të treguesit të QKZH për besueshmërinë nga niveli i 23 pikëve për tremujorin e kaluar në -8 pikë në përqindje në anketimin e fundit, duke treguar për një rënie të optimizmit të drejtuesve të kësaj nëndegë (shiko figurën 3). Për sa i përket industrisë së metalurgjisë, punimit të metaleve, fabrikimit të makinave, pajisjeve dhe pjesëve të ndërrimit, I pajisjeve elektrike etj vihet re se ka një qëndrueshmëri të treguesit të besueshmërisë. Industria e letërës, kartonit, botimeve, kimike, kaucukut dhe plastikës, rafinimi i naftës shënon një tendencë në rritje të treguesit të QKZH-së për besueshmërinë me 12 pikë në përqindje më shumë se tremujori i kaluar duke treguar për zhvillime pozitive në këtë nëndegë.

Parashikimi i aktivitetit të prodhimit

Parashikimi i aktivitetit të biznesit në industrinë përpunuese është në nivel pozitiv prej 29 pikësh, i cili është 6 pikë më i ulët se 3 muaj më parë, por ky nivel është përsëri 4 pikë më i lartë se një vit më parë (shiko figuren 4). Krahasuar me mesataren 2002-2005 ky tregues është 5 pikë në përqindje më i lartë. Balanacat pozitive të përgjigjeve në dy 3-mujorë të një pasnjëshëm tregojnë gjithashtu që në tremujorin në vazhdim të shënohet një rritje e aktivitetit industrial më e lartë se ajo e shënuar një vit më parë.

Niveli i kontraktimeve

Vlerësimi mbi nivelin aktual të kontraktimeve në sektorin e industrisë përpunuese në anketimin e muajit korrik 2006 shënon një përmirësim të dukshëm prej rreth 14 pikë në krahasim me 3 muaj më parë dhe 16 pikë po të krahasohet ky nivel me përgjigjet e një viti më parë (shiko figurën 5). Duke veçuar nivelin e këtij treguesi për kontratat e eksportit në muajin korrik vërehet gjithashtu e njëjta tendencë përmirësimi të nivelit të kontraktimeve, gjë e cila ka gjasa të mundësojë një rritje të volumit të eksporteve në 3 tremujorin e tretë të këtij viti.

FIGURA 2: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing branches




FIGURA 3: Treguesi i QKZH për besueshmërinë sipas degëve të industrisë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacturing branches






FIGURA 4: Parashikimi i aktivitetit të biznesit në industrinë përpunuese
Expectation of business activity in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 5: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë përpunuese
Assesment of order-books in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Gjendja e produkteve të gatshme

Balanca e përgjigjeve për gjendjen e produkteve të gatshme në muajin korrik 2006 tregon nivelin negativ prej 16 pikësh, i cili është 5 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë. Kjo rënie në balancën e përgjigjeve për këtë tregues ka dhënë, gjithashtu, një ndikim pozitiv në përmirësimin e klimës së biznesit, por përsëri ky nivel është rreth 11 pikë më i lartë se një vit më parë (shiko figurën 6). Krahasuar me mesataren 2002-2005 balanca e përgjigjeve për këtë tregues është me 9 pikë në përqindje më e lartë.

Aktiviteti i prodhimit në 3muajt e kaluar


Manaxherët e firmave të intervistuar vlerësojnë aktivitetin e prodhimit në 3 muajt e kaluar në një rritje në krahasim me 3 mujorin e parë si dhe në një nivel më të lartë se 3 mujori i dytë i vitit të kaluar (shiko figurën 7). Në muajin korrik 2006 balanca në përqindje e përgjigjeve të këtij treguesi është 14 pikë, duke u rritur me 10 pikë në krahasim me tre muaj më parë. Ky tregues për muajin korrik 2006 është 23 pikë më i lartë se një vit më parë. Po kështu, ky nivel është më i lartë se mesatarja e balancave të përgjigjeve të dhëna gjatë periudhës 2002-2005.

Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese

Kapacitet prodhuese në industrinë përpunuese, në bazë të të dhënave të anketimit të muajit korrik 2006, janë shfrytëzuar në një nivel prej rreth 4% më të lartë se 3 muaj më parë, duke arritur nivelin 69%, i cili është vetëm 1% më i ulët se niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese i regjistruar në muajin tetor 2005 (shiko figurën 8). Në rast se tendenca e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në këtë sektor do të vazhdojë të rritet, atëherë me siguri që do të kemi një rritje të investimeve në këtë sektor dhe për rrjedhojë, edhe një rritje të punësimit.


Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë e letrës, kartonit, botimeve, kimike, kauçikut, plastikës, rafinimit të naftës dhe koksifikimit ka vlerën minimale më të ulët me 17% ndërkohë që diferencën më të ulët midis vlerës maksimale dhe minimale vazhdon ta ketë industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit duke treguar për stabilitetin e këtij treguesi në këtë nëndegë. Vlerën maksimale në përqindje për gjithë periudhën e anketimit vazhdon e ka industria e tekstileve dhe lëkure këpucëve me 83% si dhe vlerën aktuale më të lartë me 78%.

FIGURA 6: Vlerësimi i produkteve të gatshme në industrinë përpunuese
Assesment of stocks in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 7: Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar
Assesment of production activity in manufacturing the last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 8: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Capacity utilisation in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 9: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese sipas degëve të industrisë përpunuese, 2002-2006
Capacity utilisation in manufacturing branches 2002-2006




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstileve dhe lëkure këpucëve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve
21-25 industria e letrës, plastikës, rafinimi i naftës
26 Fabrikimi i artikujve mineralo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi i metaleve, pajisjeve elektrike.

FIGURA 10: Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Assessment of production capacity in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 11: Parashikimi i çmimeve të shitjes në industrinë përpunuese
Assessment of selling prices in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 12: Parashikimi i punësimit në industrinë përpunuese
Employment expectations in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 13: Parashikimi i kontratave për export në industrinë përpunuese
Export expectation in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Vlerësimi i kapaciteteve prodhuese

Sipas parashikimit të biznesmenëve të këtij sektori në lidhje me treguesin e vlerësimit të kapaciteteve prodhuese në anketimin e fundit ka një rritje me 5 pikë në përqindje nga tremujori i kaluar. Rritja e këtij treguesi për dy tremujore të njëpasnjëshëm tregon se firmat kanë mundësi për të përballuar një rritje të nivelit të kontraktimeve për periudhën në vazhdim. Në krahasim me një vit më parë treguesi i vlerësimit të kapaciteteve prodhuese shënon një rënie prej 8 pikësh, ndërsa krahasuar me mesataren 2002-2005 rritja është me 4 pikë në përqindje.

Çmimet e shitjes

Balanca e përgjigjeve për mundësinë ose jo të rritjes së çmimeve të shitjes së produkteve në industrinë përpunuese vazhdon të tregojë një nivel të qëndrueshëm të çmimeve të prodhuesve. Kjo balancë në përqindje në muajin korrik është vetëm 2% me një rritje të njëjtë në krahasim me 3 muaj më parë, por që, përsëri është 5 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë. Kjo qëndrueshmëri në nivelin e çmimeve të prodhuesve të bën të gjykosh që të paktën për një periudhë afatshkurtër nuk do të ekzistojnë presione inflacioniste nga ana e ofertës së mallrave të konsumit.


Parashikimi i punësimit

Treguesi i parashikimit të punësimit është 18 pikë në përqindje në korrik 2006 dhe nëse krahasohet me balancën në përqindje të tre muajve më parë rritja është me 5 pike (shiko figuren 12). Situata duket shumë e përmirësuar nëse vlera aktuale e treguesit të punësimit krahasohet me një vit më parë ku treguesi i mesiperm ishte në nivelin negativ të 2 pikeve. Rritja e punësimit reflekton në këtë mënyrë dhe përmirësimin e klimës së biznesit në sektorin e industrisë përpunuese.

Parashikimi i kontratave për export


Parashikimi i kontratave për eksport ka një rritje prej 31 pikësh në përqindje krahasuar me tremujorin e dytë të 2006 duke ndikuar kështu dhe në rritjen e besueshmërisë së drejtuesve të këtij sektori. Në nivele gati të njëjta qëndron ky tregues nëse krahasohet me një vit më parë ndërkohë që shënon rritje me 13 pikë krahasuar me dy vjet më parë. Kontraktimet për eksport janë në nivel më të lartë dhe se mesatarja 2002-2005 me 19 pikë në përqindje.

FIGURA 14: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë përpunuese në 3 muajt e kaluar
Assesment of order-books in manufacture last 3 months




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 15: Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm në sektorin e industrisë përpunuese
Domestic competitive position in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURE 16: Pozicioni konkurrues në tregun e EU në sektorin e industrisë përpunuese
Foreign competitive position inside EU in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 17: Vlerësimi i nivelit të prodhimit në muaj në industrinë përpunuese
Assesment of months of production in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Niveli i kontraktimeve në 3 muajt e kaluar

Niveli i kontraktimeve në industrinë përpunuese ka pësuar një rritje të menjëhershme në tre muajt e kaluar duke kaluar në nivelin pozitiv të 26 pikëve (shiko figuren 14), duke arritur dhe vlerën më të lartë të gjithë periudhës së anketimit. Përmirësimi i nivelit të kontraktimeve tregon për një klimë optimiste të biznesit të sektorit të industrisë përpunuese. Niveli i kontraktimeve është 31 pikë në përqindje më shumë se tre muaj më parë ndërsa i krahasuar me mesataren 2002-2005 ky tregues është me 11 pikë më i lartë.

Pozicioni konkurrues në tregun e brendshëm

Përgjigjet në lidhje me pozicionin konkurrues të firmave në tregun e brendshëm tregojnë se këto të fundit kanë një përmirësim të pozicionit aktual nëse e krahasojmë me tre muaj dhe gjashtë muaj më parë me përkatësisht 12 pikë dhe 22 pikë në përqindje. Përmirësimi i nivelit të kontraktimeve në tremujorin e kaluar (shiko figurën 14) ka sjellë si rrjedhojë dhe forcimin e pozicionit të firmave që operojnë në tregun brenda vendit me 13 pikë në përqindje për anketimin e fundit.

Pozicioni konkurrues në tregun e EU-së

Pozicioni konkurrues i firmave prodhuese në tregun e Bashkimit Europian (shiko figurën 16) është përmirësuar dhe vlera aktuale e 18 pikëve në anketimin e fundit përbën dhe vlerën e dytë më të lartë përgjatë periudhës së anketimit. Në krahasim me tre muaj më parë ky tregues ka një rritje me 23 pikë duke kaluar nga niveli negativ i 5 pikëve në atë pozitiv të 18 pikëve. Rritja e nivelit të kontraktimeve nga ana e ndërrmarjeve të industrisë përpunuese që operojnë në tregun e Bashkimit Europian ka sjellë dhe rritjen e këtij treguesi.

Vlerësimi i kontraktimeve në muaj


Kontraktimet në muaj në bazë të përgjigjeve të drejtuesve të firmave prodhuese në anketimin e fundit janë mesatarisht me 10 muaj pune. Nivelet e mjaftueshme të kontraktimeve në këtë sektor kanë sjellë dhe një rritje të prodhimit në muaj. Në krahasim me tre muaj më parë ky tregues është rritur një muaj pune ndërsa me një vit më parë qëndron në të njëjtat nivele mesatare duke treguar për një rritje të parashikimeve të aktivitetit prodhues në periudhën në vazhdim.

Pengesat në sektorin e industrisë përpunuese *Constraints within manufacturing sector*

Përpara anketimit të muajit korrik 2006, keqzbatimi apo keqhartimi i legjislacionit fiskal ka qenë një nga dy faktorët më të rëndësishëm pengues në aktivitetin e industrisë përpunuese. Por anketimi i muajit korrik 2006 duket se shënon një pikë kthese në këtë drejtim, pasi këtë faktor pengues e kanë zgjedhur 29% e të anketuarve. Metalurgjia, punimi metaleve, fabrikimi makinave, pajisjeve dhe pj. të ndërrimit etj është industria ku kjo pengesë ka vlerën aktuale më të lartë me 40%. Ndikimi i tregut informal edhe në muajin korrik


vazhdon të përbëjë në mënyrë konstante një faktor kufizues dhe është pothuajse në të njëjtin nivel si në 3 muajt e kaluar. Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit ka vlerën aktuale më të lartë të kësaj pengese me 64%. Në muajin korrik 2006 ndikimi i mungesës së energjisë elektrike shënon përsëri vlerën më të ulët historike për të gjithë periudhën e anketimit 2002-2006, duke vazhduar tendencën e uljes së ndikimit negativ të këtij faktori për tre 3 muajt e njëpasnjëshëm.

FIGURA 18: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal në industrinë përpunuese
The impact of fiscal legislation in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 20: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrik e në industrinë përpunuese
The impact of shortages on electricity in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 22: Ndikimi i tregut informal në industrinë përpunuese
The impact of informal sector in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 19: Ndikimi i keq zbatimit apo keq hartimit të legjislacionit fiskal sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of fiscal legislation in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve

FIGURA 21: Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of shortages on electricity in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve

FIGURA 23: Ndikimi i tregut informal sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of informal sector in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstilëve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijëve

21-25 industria e letres, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek.

Në muajin korrik 2006 mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar si faktor kufizues në industrinë përpunuese është përmendur nga 24% e të anketuarve. Industria e tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve ka vlerën aktuale dhe maksimale më të lartë me përkatësisht 56% dhe 70% duke qenë kështu nëndega më e prekur nga mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar. Ndikimin e kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brenda vendit në anketimin e muajt korrik 2006 e kanë përmendur 34% e të anketuarve gjë, që do të thotë se duhen gjetur mënyra më efikase nga biznesi dhe qeveria për të rritur kërkesën për mallra industriale të prodhuara nga industrialistët


shqiptarë. Metalurgjia, punimi i metaleve, fabrikimi i makinave pajisjeve dhe pj.të ndërrimit etj kap vlerën maksimale më të lartë përgjatë gjithë periudhës së anketimit për këtë pengesë ndërsa industria e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike ka vlerën aktuale më të lartë me 79%. Ndikimi negativ i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm në muajin korrik 2006 ka shënuar një rënie prej 8 pikësh në përqindje në krahasim me 3 muaj më parë por rënia e këtij faktori është rrjedhojë e përmirësimit të nivelit të kontratave për eksport. Është industria e letrës, kartonit, botimeve, etj që ndjen më shumë mungesën e këtij faktori.

FIGURA 24: Ndikimi i mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar në industrinë përpunuese
The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 26: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brenda vendit
Insufficient domestic demand in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe zhvillim, Tiranë

FIGURA 28: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm
Insufficient foreign demand in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 25: Ndikimi mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of shortages of skilled labor force in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstileve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijeve
21-25 industria e letrës, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

FIGURA 27: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brenda vendit sipas degëve të industrisë përpunuese
Insufficient domestic demand in manufacturing branches



15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstileve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijeve
21-25 industria e letrës, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

FIGURA 29: Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of Insufficient foreign demand in manufacturing branches




15-16 Industria ushqimore, e pijeve dhe duhanit
17-19 industria e tekstileve dhe lekure kepuceve
20-36 Fabrikimi i artikujve prej druri, mobilijeve
21-25 industria e letrës, plastikes, rafinimi i naftes
26 Fabrikimi i artikujve minerale jo metalike
27-35 Metalurgjia, punimi metaleve, pajisjeve elek

Nga figura 30 shikohet se mungesa e kredisë bankare është një faktor pothuajse i papërfillshëm për biznesin në sektorin e industrisë përpunuese, pasi këtë faktor e kanë cilësuar si pengues vetëm 3% e firmave të anketuara, nga rreth 13% që e kanë përmendur 3 muaj më parë këtë faktor. Vlerën aktuale më të lartë e ka nëndega e industrisë së tekstileve, veshjes dhe lëkurë këpucëve me 5%. Përmirosimi në përgjithësi i klimës së biznesit dhe në veçanti eliminimi i mjaft pengesave me ndikim në ambjentin e biznesit ka bërë që të përmirësohet edhe situata financiare e firmave të anketuara në sektorin e industrisë përpunuese. Është industria e fabrikimit të artikujve prej druri,


mobliljeve, etj ku ky faktor ka vlerën më të lartë aktuale me 34%. Korupsionin si faktor pengues në muajin korrik e kanë përmendur vetëm 11% e biznesmenëve në sektorin e industrisë përpunuese. Ky është niveli më i ulët historik për të gjitha anketimet e zhvilluara nga QKZH-ja nga janari i vitit 2002. Ky nivel është rreth 13% më i ulët se 3 muaj më parë dhe rreth 17% më ulët se një vit më parë. Industria e fabrikimit të artikujve minerale jo metalike ka vlerën maksimale të kësaj pengese me 82% ndërsa industria e tekstileve veshjes dhe lëkurë këpucëve ka vlerën aktuale më të lartë me 22% .

FIGURA 30: Vështirësitë për të siguruar kredi në sektorin e industrisë përpunuese
Difficulties in obtaining credit in manufacturing sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 32: Ndikimi i korupsionit në sektorin e industrisë përpunuese
The impact of corruption in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 34: Vështirësitë financiare në sektorin e industrisë përpunuese
Financial constrains in manufacturing sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 31: Vështirësitë për të siguruar kredi sipas degëve të industrisë përpunuese
Difficulties in obtaining credit in manufacturing branches




FIGURA 33: Ndikimi i korupsionit sipas degëve të industrisë përpunuese
The impact of corruption in manufacturing branches





FIGURA 35: Vështirësitë financiare sipas degëve të industrisë përpunuese
Financial constrains in manufacturing branches



SEKTORI I NDERTIMIT

CONSTRUCTION SECTOR

Klima e biznesit

Treguesi i besueshmërisë në sektorin e ndërtimit në muajin korrik 2006 tregon se situata e biznesit në kete sektor për tremujorin e tretë të këtij viti pritet të dobësohet. Rënia e treguesit të besueshmërisë ka ardhur nga rënia e parashikimeve për rritjen e punësimit në 3 muajt e ardhshëm. Në muajin korrik 2006 treguesi i besueshmërisë së QKZH-se në sektorin e ndërtimit shënon vlerën e -6 pikëve, duke shënuar një rënie prej 1 pikë në përqindje në krahasim me tremujorin e kaluar (figura 36). Ky nivel është, gjithashtu, 4 pikë më i ulët krahasuar me një vit më parë (korrik 2005), por është pak a shumë në mesataren e këtij treguesi për periudhën 2002 – 2005.

Niveli i kontraktiveve

Treguesi i nivelit aktual të kontraktiveve në muajin korrik shënon vlerën e -18 pikëve. Ky nivel tregon një përmirësim prej 6 pikësh të mjaftueshmërisë së nivelit të kontraktiveve i krahasuar me tremujorin e kaluar. Krahasuar me një vit më parë ky nivel është me rreth 1 pikë më të ulët, ndërsa është pothuajse në nivelin e mesatares 2002 - 2005 e këtij treguesi. Përmirësimi në nivelin e kontraktiveve në ndërtim tregon se ky sektor duket se e ka prekur nivelin e tij më të ulët, duke siguruar një qëndrueshmëri në nivelin aktual të ndërtimit.


Parashikimi i punësimit

Treguesi i parashikimi të punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit pëson një ulje në krahasim me 3 muajt më parë dhe nivelin e një viti më parë. Në korrik 2006 balanca e përgjigjeve në lidhje me këtë pyetje është pozitive prej 7 pikësh, nivel ky që është 8 pikë më i ulët se një vit më parë dhe 6 pikë më i ulët se 3 muajt më parë. Duke përjashtuar efektin sezonal, ku punësimi në ndërtim pëson një rënie në 3 muajorin e tretë dhe të katërt, dobësia në rritjen e kërkesës për fuqi të re punëtore duket se ka ardhur kryesisht nga mungesa e perspektivës për sheshe dhe kontrata të reja ndërtimi.

Aktiviteti i prodhimit në 3 muajt e kaluar


Aktiviteti i prodhimit në 3 muajt e kaluar tregon rënie në krahasim me të dhënat e regjistruara një vit më parë. Nga figura 39 vihet re, se në muajin korrik 2006 balanca e përgjigjeve të manaxherëve të firmave të ndërtimit mbi situatën në aktivitetin e ndërtimit në 3 muajt e kaluar është në vlerën e 7 pikëve, e cila është 5 pikë në përqindje më e ulët se një vit më parë. Ky nivel në përqindje i krahasuar me muajin prill 2006 është 5 pikë më i lartë.

FIGURA 36: Treguesi i besueshmërisë së QKZH-së në sektorin e ndërtimit
CRD confidence indicator in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 37: Vlerësimi i nivelit të kontratave në sektorin e ndërtimit
Assessment of order-books in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 38: Parashikimi i punësimit për 3 muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit
Employment expectation in construction sector (next 3 months)



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 39: Vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit në 3 muajt e fundit
Assessment of business activity in the last 3 months in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Çmimet në ndërtim

Balanca e përgjigjeve në lidhje me çmimet e ndërtimit edhe në muajin korrik 2006 jo vetëm që vazhdon të mbetet pozitive, por ritmet e kësaj rritjeje janë më të larta të krahasuara këto si me 3 mujorin e kaluar ashtu edhe ato të një viti më parë. Kështu treguesi i balancës së pyetjes se, si do të jenë çmimet e ndërtimit në muajin korrik është pozitive prej 47 pikë, nivel ky 10 pikë më i lartë se 3 muaj më parë dhe 8 pikë në përqindje më i lartë se një vit më parë. Këto të dhëna tregojnë se rritja e çmimeve të ndërtimit do të vijojë me një tendencë më të fortë rritjeje për të paktën edhe për 3 mujorin e ardhshëm.

Niveli i kontraktimeve në muaj

Niveli i kontraktimeve në muaj në sektorin e ndërtimit vlerësuar në muajin korrik 2006 është mesatarisht 9 muaj. Krahasuar me një vit më parë ky tregues është 1 muaj më pak, por ai është 1 muaj më tepër se 3 muaj më parë, gjë që konfirmohet edhe nga përmirësimi i nivelit të mjaftueshmërisë në nivelin e kontraktimeve. Në krahasim me mesataren 2002-2005 niveli i kontraktimeve në anketimin e fundit është i njëjtë.

Pengesat në sektorin e naerumit Constraints within construction sector


Procedurat për leje ndërtimi

Ndikimi i procedurave për leje ndërtimi vazhdon të konsiderohet si faktori më kryesor pengues nga ndërtuesit e intervistuar. Në muajin korrik 2006, 67% e të anketuarve e kanë përmendur këtë faktor si një nga pengesat e tyre (shiko figurën 42). Ky nivel është 6 pikë në përqindje më e lartë se në muajin prill 2006 duke arritur të njejtën shtrëngesë për biznesin si në verën e vitit 2005. Në krahasim me dy vjet më parë por dhe me mesataren 4 vjecare kjo pengesë ka pësuar një rritje me 6%.

Legjislacioni fiskal


Legjislacioni fiskal i keq-hartuar apo keq-zbatuar është nga faktorët që në 3 anketimet e fundit përmendet në mënyrë konstante nga rreth 52-55 % e të anketuarve. Në muajin korrik ai përmendet nga 52% e të anketuarve, nivel i cili, megjithëse është rreth 12% më pak se një vit më parë, tregon se qeveria dhe administrata tatimore në veçanti, ka bërë pak për lehtësimin e procedurave tatimore në këtë sektor. Niveli aktual i kësaj pengese është më i ulët madje dhe se mesatarja 2002-2005 me 2 % më pak.

FIGURA 40: Parashikimi i çmimeve në sektorin e ndërtimit
Price expectations in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 41: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në muaj në sektorin e ndërtimit
Work already contracted in months in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 42: Ndikimi i procedurave për leje ndërtimi
Building licensing procedures in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 43: Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit
The impact of financial legislation in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 44: **Konkurrencë e pandershme nga tregu i zi në sektorin e ndërtimit**
Unfair competition by black market in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 45: **Ndikimi i mungesave të energjisë elektrike në sektorin e ndërtimit**
The impact of shortages on electricity in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 46: **Mos zbatim korrekt i ligjit të prokurimit në sektorin e ndërtimit**
Not correct implementation of the procurement law in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 47: **Ndikimi i faktorëve makroekonomikë në sektorin e ndërtimit**
The impact of macroeconomic factors in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Aktiviteti informal

Në anketimin e muajit korrik vërehet një rritje e ndikimit frenues që vjen nga aktiviteti informal në këtë sektor. Kështu, ky faktor përmendet nga 41% e të anketuarve nga rreth 23 % që përmendej 3 muaj më parë. E parë në krahasim me një vit më parë kjo pengesë shënon ulje me 5%. Kjo tregon se masat e qeverisë për të shmangur ndikimin e tregut të zi në këtë sektor janë jo të plota duke ndikuar në këtë mënyrë në ecurinë normale të biznesit në sektorin e ndërtimit.

Energjia elektrike

Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike po bëhet pothuajse i papërfillshëm si faktor pengues në sektorin e ndërtimit. Në muajin korrik vetëm 11% e të anketuarve e kanë nënvizuar mungesën e energjisë elektrike si faktor pengues, duke zbritur në këtë mënyrë në nivelet më të ulta historike. Në krahasim me tre muaj më parë kjo rënie është me 25% ndërsa nga mesatarja 2002-2005 është 45% më pak. Niveli aktual i mungesave të energjisë elektrike shënon nivele të ulta dhe nëse krahasohet me një vit por dhe me dy vjet më parë me përkatësisht 19% dhe 48 % (shiko figurën 45).

Zbatimi i ligjit të prokurimit

Zbatimi jo korrekt i ligjit të prokurimit është një faktor pengues konstant. Ky faktor përmendet nga rreth 22% e të anketuarve, me një përmirësim prej rreth 13% në krahasim me një vit më parë (shiko figurën 46). Në korrik 2006 ky faktor kufizues ka pësuar një rënie me 3% nga tremujori i kaluar ndërkohë që në krahasim me mesataren 2002-2005 rënia është me 11% duke treguar kështu për një ulje të peshës së ndikimit të zbatimit jokorrekt të ligjit të prokurimit në sektorin e ndërtimit.

Faktorët makroekonomike

Ndikimi i faktorëve makroekonomike (si lëvizjet e shpeshta të kursit të këmbimit, çmimet me pakicë apo i lëndëve të para) është përmendur nga vetëm 13% e drejtuesve të firmave të ndërtimit në anketimin e fundit të korrikut 2006, duke mbetur në nivele minimale (shiko figurën 47). Ky nivel tregon rezultatet e dy anketimeve paraardhëse dhe flet për një qëndrueshmëri të klimës makroekonomike për biznesin në sektorin e ndërtimit.

TË PËRGJITHSHME

Gjatë anketimit të muajit korrik 2006 u kontaktuan rreth 550 firma në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit në rrethet Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Shkodër. nga të cilat u përgjigjën brenda periudhës së anketimit, rreth 500 firma. Anketimi i biznesit në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit ka filluar në muajt janar dhe prill të vitit 2002. Anketimi bazohet mbi vlerësimin cilësor të opinionëve të menaxherëve apo pronarëve të ndërmarrjeve të kontaktuar. Vlerësimet cilësore përpunohen në formën e treguesit të Balancës, e cila shpreh diferencën midis përgjigjeve optimiste (në rritje, apo përmirësim) kundrejt atyre pesimiste (në ulje, apo përkeqësim) duke përjashtuar nga vlerësimi opinionet që shprehin situatë të pandryshuar. Në këtë mënyrë kur balanca e përgjigjeve është pozitive vlerësimet e optimistëve tejkalojnë ato të pesimistëve dhe në të kundërtën do të kishim një balancë negative. Klima e biznesit vlerësohet nëpërmjet indikatorit të besueshmërisë. Ky indikator për sektorin e industrisë përpunuese llogaritet si mesatare aritmetike e tre indikatorëve: parashikimit të prodhimit, vlerësimin e kontratave të realizuara, dhe vlerësimin e produktit të gatshëm (i marrë me shenjë të kundërt). Për sektorin e ndërtimit indikator i besueshmërisë llogaritet si mesatare aritmetike e treguesit mbi vlerësimin e kontraktimeve aktuale dhe parashikimit të punësimit.

QENDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është kryerja e studimeve dhe analizave ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit nëpërmjet anketimeve periodike. Duke analizuar problematikat e biznesit dhe publikut dhe shpërndarjen e rezultateve synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të jetës të të gjithë qytetarëve.

Drejtoresha Ekzekutive/ *Executive Director*:
Mirlinda Rusi (Gajo)

Anëtarët e grupit / *Group's members*
Jonida Naska
Rozi Poga (Beqiri)
Bexhet Hyka

Duke ndjekur të njëjtën praktikë për periudha rigorozisht të përcaktuara (mujore apo tremujore), mbi bazën e balancave ndërtohen indikatorë të caktuar të biznesit që shprehin situatën e biznesit në raport me periudhat e mëparshme, situatën aktuale dhe parashikimin për një periudhë të paktën 3 mujore. Anketimet e biznesit shërbejnë, gjithashtu, jo vetëm për të ndjekur tendencën e biznesit, por me anë të tyre diktohen ciklet e biznesit, si dhe pikat e kthesës në ciklin e biznesit. Kjo metodë anketimi zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet Kandidate, si dhe me pak ndryshime në të gjitha vendet anëtare të OECD-së. Në Evropë, një nga institutet më prestigjioze që ka filluar anketimet cilësore të biznesit është KOF Instituti Zvicërian për Analizën e Ciklit të Biznesit në Zyrih, Zvicër (viti 1955). Stafi teknik i QKZH-së në periudhën 8 -12 qershor 2005 ka marrë pjesë në tavolinat e punës të organizuara nga KOF posaçërisht për rritjen e kapaciteteve teknike të saj në fushat specifike si: hartim metodologjie për përzgjedhjen e kampionit në sektorët e industrisë përpunuese dhe ndërtimit për Shqipërinë; analizë ekonomike për interpretim të rezultateve në lidhje me tendencën e biznesit dhe vlerësimin e indikatorëve sintetike; implementim teknik të tendencave sipas anketimit në bizneset industri përpunuese dhe ndërtim.

CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publish research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.